



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.3258/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, si gjykatë civile e shkallës së parë, e kryesuar nga gjyqtari Bujar Dobërdolani, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", nr. 21, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, lidhur me propozimin për caktimit të masës së përkohshme, me datë 30.09.2019 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. REFUZOHET propozimi i paditësit/propozuesit Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme ashtu që të kërkohej nga i padituri/kundërshtari i sigurimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë rishikimi i listave të partive politike, ashtu që të njëjtat të jenë në pajtim me dispozitat e nenit 6, par 8 dhe 14 të Ligjit për Barazi Gjinore, si i pa bazuar.

Arsyetim

Paditësi, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar padia e tij, të vërtetohet se sjellja e KQZ-së, ka shkelur të drejtën e trajtimit të barabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të ndalohej ndërmarrja e veprimeve të cilat shkelin apo mund të shkelin të drejtën për trajtim të barabartë, apo të kryhet veprimtari të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e tij në lidhje me trajtimin e pabarabartë të grave në të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, ta Publikojnë në media vendimin i cili vërteton shkeljen e se drejtës për trajtim të barabartë. Paditësi ndër të tjera ka deklaruar se pas shpalljeve të zgjedhjeve të parakohshme nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, me vendimin 236/21019, dorëzimit të Listave me emrat e kandidatëve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga subjektet politike, Komisioni Qendror Zgjedhor me vendimet individuale për secilën parti politike, e ka miratuar rekomandimin e zyrës për certifikimin e partive politike. Nga të gjitha subjektet politike janë propozuar 1067 kandidatë, ku prej tyre 337 janë të gjinisë femërore, ndërsa 730 janë të gjinisë mashkullore. Bazuar në konstatimet e lartcekura ka deklaruar se i padituri nuk ka vepruar në pajtueshmëri me ligjin, meqenëse është dashur që në pajtim me dispozitat e ligjit për barazi gjinore, pa marr parasysh se çfarë përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në kuptimin e përcaktimit të kuotave gjinore.

Paditësi së bashku me padinë ka parashtruar edhe propozimin për masë të përkohshme, me të cilën ka propozuar që të kërkohet nga i padituri/kundërshtari i sigurimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë rishikimi i listave të partive politike, ashtu që të njëjtat të jenë në pajtim me dispozitat e nenit 6, par 8 dhe 14 të Ligjit për Barazi Gjinore.

Gjykata shqyrtoi me kujdes propozimin për masën të përkohshme si dhe deklarimve të palës paditëse në padi-propozim, lidhur me caktimin e tani masës së përkohshme dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse/propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, është i pa bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, në mënyrë decitive ceket se "Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kështillë pala kundërshtar e do të mund të pamundësohte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fsheljen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit". Po ashtu me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit, ndërsa me nenin 304.3 të LPK -së, është përcaktuar se, mes tjerash, "propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregojë edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim", si dhe që këto "mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit".

Duke vendosur sipas propozimit e palës paditëse/propozuesit, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme ashtu që të kërkohet nga i padituri/kundërshtari i sigurimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë rishikimi i listave të partive politike, ashtu që të njëjtat të jenë në pajtim me dispozitat e nenit 6, par 8 dhe 14 të Ligjit për Barazi Gjinore, gjykata të njëjtin e ka vlerësuar si të pa bazuar për shkak se pala paditëse nuk ka ofruar prova për të vërtetuar fakte relevante, apo bërë të besueshme të njëjtat sa i përket të drejtës subjektive, nuk ka provuar se kush janë subjektet konkret/individët që nuk janë përfshirë në lista zgjedhore, e që janë diskriminuar, me qka do ta bënte të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive, si një nga kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Me nenin 306 të LPK-së, është paraparë se masa e përkohshme mund të caktohet po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit. Tutje, duhet cekur se kjo masë nuk qëndron vet për vete, por duhet t'i referohet ndonjëris nga masat e përcaktuara me nenet 299 deri 301 të LPK-së, e që paditësi/propozuesi në Propozimin e tij, asnjërin nga to nuk e ka specifikuar si kërkesë për të cilën duhet të vendos gjykata.

Gjykata ka për obligim edhe të zbatojë dispozitat ligjore të aplikueshme sa i përket kushteve për caktimin e masave të përkohshme. Kërkesa për masë i nënshtrohet rregullave të caktuara procedurale, shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat vendoset, duhet të jenë të besueshme dhe të bazuara. Është përcaktim ligjor që, propozuesi i masës së sigurimit kur kërkon që të vendoset

masa e përkohshme, duhet që rrezikun dhe shkaqet për caktimin e masës së përkohshme t'i paraqesë në propozimin e tij të cilin ia drejton gjykatës, e që në rastin konkret, paditësi/propozuesi nuk e ka bërë.

Veç të lartcekurave, gjykata gjatë analizimit të propozimit për masë, ka gjetur se propozimi në fjalë është i pa bazë, kjo edhe për faktin se me aprovimin eventual të propozimit për caktimin e masës së përkohshme të propozuar, gjykata do të prejudikonte vendimin edhe sa i përket çështjes kryesore/kërkesëpadisë, ngase me masë të përkohshme nuk mund të zgjidhet/prejudikohet çështja kryesore, por me të vetëm sigurohet kërkesëpadia, në rastin konkret sikur gjykata të urdhëronte me masë që listat zgjedhore të jenë sipas propozimit të propozuesit, do të zgjidhte/prejudikonte çështjen kryesore.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzojë propozimin e paditësit/propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, duke gjetur se në rastin konkret i njëjti është identik me kërkesën kryesore.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 387.1 pika (l), lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3258/19, datë 30.09.2019



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 310.5 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.